



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën shkronjën d) nenin 17 nën shkronjën a) nenit 40 paragrafi 2 nën shkronjën l) nenit 58 nën shkronjën i) të LVL nr.03/L-040, Dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, dispozitat e Ligjit për Kufijet Administrativ të Komunës nr.03/L-041, Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr.04/L-174, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit nr.03/L-048 dhe Ligjit për Ndryshimet e tija, nenit 10 nën 4) nenit 40 paragrafi 2 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, të Debatit me Publikun të dt.23.05.2017, të seancës së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.16.06.2017, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të, të rregullt për vitin 2017, të mbajtur më 29.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021

I

Miratohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik për Komunën e Klinës 2017-2021.

II

Strategjia si në pikën 1 të këtij vendimi miratohet duke marrë par bazë të gjitha vërejtjet dhe propozimet e parashtruara në Debatin me Publikun, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe ato në Kuvendin e Komunës të cilat nuk hasin në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

III

Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi si dhe inkorporimin e propozimeve të parashtruara për venje në Strategji si në pikën 1 të këtij vendimi, janë: Kryetari, Drejtoria e Financave Ekonomi dhe Zhvillim në koordinim me Grupin punues të hartimit të këtij dokumenti.

IV

Ky vendim hyn në fuqi me miratimin nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe konfirmimit të tij nga autoriteti mbikqyrës- 15 ditë pas protokolimit të tij për shqyrtimin e ligjshmerisë conform nenit 81 të LVL dhe publikohet conform nenit 17 dhe 18 të Rregullores së QRK nr.01/2013, së bashku me tekstin final të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave, Grupi për hartimin e Strategjisë, Zyra Ligjore, Sherbimi i Kuvendit dhe Arkivi i Komunës Klinë.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3613 2017
Klinë, 05.07 2017

